VENDIM
Nr. 901, datë 18.11.2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare për Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar fillojnë nga momenti i funksionimit të këtij komiteti dhe përballohen nga buxheti i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga të ardhurat e realizuara nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela

Emërtesa e Bordit/Këshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në Lekë	
		Kryetari	Nr. i Anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar	12	1	8	20,000	20,000